



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA

[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)



## KOMUNA KLINË

Drejtoria e Financave dhe Zhyllimit Ekonomik

05 Nr. 016 - 21634102  
Klinë, datë 24.06.2022

## PROCES VERBAL

Nga Debat me Publikun me lokalitetet: Jashanicë, Pograxhë, Gjurgjevik i Madh dhe Dush, i cili u mbajt në objektin e shkollës fillore të mesme të ulët “Tre Dëshmorët”, në fshatin Jashanicë. Tubimi u mbajt me datë 21 qershor 2022 dhe filloi në orën 18:30, ku morën pjesë: 15 persona.

## RENDI I DITES

1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2023-2026.

Për këtë pikë të rendit të ditës fjalën hyrëse e paraqiti ushtruesi i detyrës së drejtorit të drejtorisë së Financave dhe Zhvillimit Ekonomik, z. Ajet Sejdiu, i cili paraqiti buxhetin për vitin 2023 dhe projektet e planifikuara.

Z. Sejdiu para pjesëmarrësve paraqiti një përbledhje të planifikuar të shpenzimeve dhe të hyrave buxhetore për komunën e Klinës për periudhën afatmesme 2023-2025 si dhe shpërndarjen e resurseve financiare nëpër programe komunale sipas prioriteteve të qeverisë komunale të nxjerra nga dokumentet strategjike komunale dhe vendimet e Kuvendit komunal të Klinës të cilat pasqyrohen në këtë dokument kornizë.

## DISKUTIMET

1. Ukë Berisha shprehi pakënaqësi në mos ndërtimin e kanalizimit ne Jashanicë nga lagjia Hoti deri te shkolla. Kërkoi që një projekt i tillë të realizohet.
2. Tahir Berisha nga fshati Gjurgjevik i Madh, paraqiti si kërkesë riparimin e urës dhe rrugës në fshatin Gjurgjevik i Madh si dhe një trotuar në rrugën “Dëshmoret e Lirisë”.
3. Agim Avdija, paraqiti kërkesë për tërheqjen e impiantit të vogël të ujrave të zeza e cila pengon shtëpitë e fshatit te ura e Resnikut, kërkesë tjetër kishte ndërtim e kanalizimit te lagjia Avdija
4. Marjan Toplanaj nga fshati Pogradje kërkesë kishte rregullimin ose tërheqjen e trafes me tension te lart te rrymës në lagje.
5. Fadil Bullaku nga fshati Jashanice, kërkesë për pastrimin dhe zgjerimin e lumit qe kalon ne lagjen e Bullakve.

Pas shumë diskutimeve, banorët në fund njëzëri u akorduan se projekt prioritet të mbetët asfaltimi i rrugës “Afrim Haliti”.

Takimi përfundoi në orën 19:28.

Procesmbajtësi

